



Ky projekt financohet nga Bashkimi European  
The project is financed by the European Union

## PYETJET MË TË SHPESHTA RRETH THIRRJES PËR PROJEKT-PROPOZIME

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri në Bashkëpunim me Shërbimin Ligjor Falas në Tiranë (TLAS) kanë hapur thirrjen për projekt propozime në kuadër të projektit “Zhvillimi i OSHC-ve për Familjet Kudjestare në Shqipëri” i financuar nga Bashkimi European.

### Pyetja 1

A mund të aplikojnë 2 CSO së bashku?

Nese po, a mund të jetë lead-applicant CSO nga Elbasani dhe co-applicant CSO nga Tirana, apo duhet e kundërta?

### Përgjigja 1

Patjetër që mund të aplikojnë dy CSO së bashku. Lead aplikanti mund të jetë nga çdo qytet i Shqipërisë, mjafton që projekti të zbatohet në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Korçës.

### Pyetja 2

A mund te aplikoj më shumë se njëherë në këtë thirrje?

### Përgjigja 2

Jo nuk mund të aplikoni më shumë se një herë në këtë thirrje të parë?

### Pyetja 3

Në këtë thirrje të parë mund të jem edhe lead aplikant dhe co-aplikant në të njëjtën kohë?

### Përgjigja 3

Ju duhet të zgjidhni vetëm njëren prej tyre për të aplikuar në këtë thirrje?



Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian  
The project is financed by the European Union

#### **Pyetja 4**

Ne jemi një organizatë e re e krijuar në vitin 2018 dhe dëshirojmë të aplikojmë në këtë thirrje, por a duhet të dorëzojmë bilancin e organizatës?

#### **Përgjigja 4**

Nëse ju aplikoni si lead aplikant duhet që patjetër të dorëzoni bilancin e organizatës, por nëse jeni bashkë aplikant atëherë kjo nuk ju kërkohet.